



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 12 mars 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SPITALLA SOLAR” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.

U miratua kërkesa e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

U miratua kërkesa e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për HEC Moglicë dhe HEC Banjë.

U miratua kërkesa e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

U miratuan disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, si dhe treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike.

Nuk pati çështje të tjera për shqyrtim.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.